

AKT - THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA

“NOAH-AM” SH.P.K.

Sot, më 06.03.2025 në Berat, Une Ortaku Themelues:

Armando Qajalliu i biri i Mehdi-ut i datelindjes 30.09.1991 i identifikuar me dokumentin Pashaportë BC7346588 dhe Numer Personal J10930076I, banues ne adresen: Lagja “28 Nentori”, Rruga “Veri Zalosnjaja”, 00010532; Nd.55; H.1; Berat, 5001,-ne Bashkine Berat.

Në bazë të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërit Tregtare” i ndryshuar, si dhe ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” i ndryshuar, me vullnetin tim të lirë, hartojme kete Akt –Themelimi te Shoqërisë Tregtare **“NOAH-AM”** sh.p.k. si më poshtë vijon:

FORMIMI I SHOQËRISË

Neni 1

Themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **“NOAH-AM” sh.p.k.**

Shoqëria e zhvillon veprimtarin e saj tregtare në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi, tregtar, doganor, tatimor, dhe aktet e tjera ligjore e nën ligjore në fuqi, sipas objektit të veprimtarisë së saj mbi bazën e këtij akti dhe statutit të saj dhe normat e së drejtës tregtare ndërkombëtare.

Shoqëria fiton personalitetin juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

QËNDRA, TERRITORI

Neni 2

Selia e shoqërisë **“NOAH-AM” sh.p.k.** ndodhet ne Lagja “28-Nentori”, Rruga “Antipatrea”, Ndertesa 39, Hyrja 1, Pasuria nr.27/201-N2, Vol.8 Faqe 168, zona kadastrale 8502, Berat, 5001, Bashkia Berat.

Shoqëria mund të hapë edhe filiale, përfaqësi, agjensi operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Me miratim të organeve kompetente shtetërore, shoqëria, mund të hapë dhe filiale, degë, përfaqësi, agjensi të saj edhe jashtë vendit.



KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë tregtare **“NOAH-AM”** sh.p.k, do të jetë me afat të pacaktuar dhe mbi 10 vjet, duke filluar ky afat nga dita e regjistrimit të shoqërisë si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, duke kryer më parë të gjitha veprimet e likuidimit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4

Selia e shoqërisë **“NOAH-AM”** sh.p.k. ndodhet ne Lagja “28-Nentori”, Rruga “Antipatrea”, Ndertesa 39, Hyrja 1, Pasuria nr.27/201-N2, Vol.8 Faqe 168, zona kadastrale 8502, Berat, 5001, Bashkia Berat, do të jetë:

1. Veprimtari te kembimit valutor.

Për kryerjen e veprimtarisë së saj, shoqëria do të hap njësi, tregtimi, shërbimi, prodhimi dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë e juridik vendas dhe të huaj.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë i regjistruar është 3.000.000 (tre milion) lekë dhe është kontribut i ortakut themelues të shoqërisë ne mjete monetare.

Vlera e kapitalit te regjistruar te shoqerise eshte 3.000.000 leke dhe është kontribut i ortakut themelues të shoqërisë Armando Qajalliu, vlera e pjeses se kapitalit eshte 3.000.000 leke,.

Vlera e kapitalit themeltar eshte ne 1 (nje) kuote me vlere totale te kapitalit 3.000.000 leke, kuota e kapitalit zoterohet nga ortaku themelues Armando Qajalliu, ka nje kuote me vlere nominale te kuotes 100% te kapitalit te shoqerise.

Vlera e kapitalit te regjistruar te papaguar ne shumen 3.000.000 leke do te derdhet ne llogarit bankare te shoqerise brenda 30 diteve kalendarike nga momenti i regjistrimit te shoqerise nga ortaku themelues.

Kapitali themeltar mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit të ortakeve themelues. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkruheshëm.

Pjesët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie, por ato mund t'u transferohen personave të tretë, që nuk bëjnë pjesë në ortakëri, por, gjithmonë me vendim të ortakeve themelues dhe me akt - noterial, konform ligjit.



Fitimi që do të realizohet gjatë veprimtarisë ekonomike të shoqërisë do të administrohet nga ortakët themelues. Një pjesë e këtij fitimi do të përdoret për investime dhe zgjerimin e aktivitetit tregtar.

Ky fitim do të disponohet lirisht prej ortakëve themelues, pasi shoqëria të ketë shlyer më parë detyrimet ligjore.

Për kryerjen e veprimtarisë së saj, shoqëria do të hap njësi prodhimi, shërbimi, tregtimi dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë e juridik vendas dhe të huaj.

Shoqëria mund të ushtrojë dhe aktivitete të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi, të konsideruara me përfitim dhe të dobishme për arritjen e objektivave të saj kryesore.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 6

Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë, emëron si Administrator të shoqërisë **“NOAH-AM”** sh.p.k. z. Armando Qajalliu, me afat për 5 (pesë) vjet, afat i cili fillon menjëherë me regjistrimin e shoqërisë si person juridik në Q.K.B, për periudhën 06.03.2025 deri 05.03.2030.

Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë është organi më i lartë drejtues dhe vendimor i shoqërisë, ai ushtron të gjitha kompetencat që i jep ligji “Për tregtarët dhe shoqërit tregtare”.

Me vendim të Asamblese së Ortakëve të Shoqërisë mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptarë apo të huaj ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare brenda dhe jashtë vendit.

Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë mund të delegojë kompetencat një ose më shumë administratorëve të emëruar prej saj ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë, vetëm mbi bazën e prokurës noteriale.

Marrëdhëniet me të tretët shoqëria i ndërton mbi bazën e reciprocitetit dhe kontratës, sipas kërkesave dhe objektivit të saj, konform legjislacionit në fuqi.

Marrëdhëniet juridike midis shoqërisë dhe të punësuarve do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punës në përputhje me Kodin e Punës dhe ligjet në fuqi.

Llogaritë vjetore të shoqërisë mbahen nga kontabilist të miratuar i cili emërohet nga administratori i shoqërisë, ose mund të emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë.

Kontrolli i llogarive vjetore të shoqërisë kryhet nga ekspertë kontabël të autorizuar dhe emërohet e shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë.

Çdo vit financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor.

Përgjashtimisht viti i parë financiar ka filluar ditën e themelimit si person juridik.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 7

Shoqëria do të ketë vulën e saj. Vula duhet të mbajë stemën dhe shkrimet e nevojshme që tregojnë emrin e shoqërisë.



Neni 8

Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë Akt –Themelim dhe në Statutin e shoqërisë, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil dhe dispozitat ligjore të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërit Tregtare”.

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të kësaj shoqërie do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërtën kur mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetentë për zgjidhjen e tyre është Gjykata ku ndodhet selia ligjore e shoqërisë.

Akti – Themelimit nënshkruhet rregullishtë, pa vërejtje, nga Une ortaku themelues.

Ky Akt – Themelimi është hartuar në 4 (kater) kopje të barabarta dhe të barazvlefshme

PËR SHOQËRIN “**NOAH-AM**” SH.P.K.

ORTAKU THEMELUES

ARMANDO QAJALLIU

Armando Qajalliu
